



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.11.2023, ora 14:00 (*online*)

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 3, 10 dhe 18 tetor 2023.
2. Diskutimi me Ministrinë e Brendshme në lidhje me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Antoneta Dhima, Bardhyl Kollçaku, Toni Gogu, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Paulin Sterkaj, Luan Duzha, Ilirian Pendavinji, Kasem Mahmutaj, Asllan Dogjani, Lindita Metaliaj, Klevis Xhoxhi dhe Arkend Balla.

Mungojnë:

Agron Çela, Flamur Noka, Ervin Salianji, Enkelejd Alibeaj, Isuf Çelaj, Ferdinand Xhaferraj, Monika Kryemadhi dhe Lefter Gështenja.

Të ftuar:

Taulant Balla – ministër i Brendshëm

Besfort Lamallari – zëvendësministër i Brendshëm

Besmir Beja – sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme

Viktor Hysaj – drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Brendshme

Fran Brahimi – drejtor në Drejtorinë e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor, Sektori i Programimit Buxhetor, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vilma Çausholli – përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor, Sektori i Analizës së Buxhetit Qendror, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço – Të nderuar kolegë të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, ju lutem hapni kamerat për të filluar procedurën në lidhje me diskutimin dhe miratimin e projektbuxhetit të vitit 2024! Ky votim bëhet ndryshe nga herët e tjera, në pamundësi për ta zhvilluar në mënyrë fizike në sallën e Komisionit, për arsye se një grup i deputetëve të opozitës mendojnë se kjo është zgjidhja më e mirë. Në pamundësi objektive dhe në mënyrë inovative po fillojmë diskutimin dhe miratimin *online* të buxhetit për vitin 2024. Për këtë arsye kemi thirrur në Komision ministrin e Brendshëm, zotin Balla; zotin Besfort Lamallari, zëvendësministër; zotin Besmir Beja, sekretar i Përgjithshëm dhe zotin Viktor Hysaj, drejtor i Buxhetit, të cilët janë prezentë. Faleminderit!

Gjithashtu, kemi edhe përfaqësues nga Ministria e Financave, zonjën Mimoza Dhëmbi.

Asllan Dogjani – Për procedurë, zoti Kryetar!

Nasip Naço – Thoni më mirë që nuk doni të vazhdojë Komisioni dhe ne të gjithë e kuptojmë.

Asllan Dogjani – Për procedurë, zoti Kryetar, që të marr fjalën! Edhe këtu nuk doni të na lini?

Nasip Naço – Por ka një rregull.

Asllan Dogjani – Zotëri, ma jep fjalën për procedurë!

Nasip Naço – Si për procedurë? Është hera e parë që e kërkojmë fjalën për procedurë, ende pa filluar kryetari?!

Asllan Dogjani – Ti mbarove dhe fillove të bësh politikë. Për procedurë, zotëri!

Nasip Naço – Nuk ju thashë që ishit me karrige dhe na bllokuat derën, sepse ju kurseva.

Asllan Dogjani – Po, është e vërtetë, e kemi bllokuar derën. E kemi bllokuar ne derën, deputetët e opozitës, të Partisë Demokratike, sepse ju nuk zbatoni asnjë procedurë, asnjë rregull dhe Kushtetutë, që na japin neve të drejta, si opozitë parlamentare, për të krijuar dhe ngritur komisionet hetimore. Ju na keni ndaluar!

Nasip Naço – Në gjendjen e dëshpëruar ku gjendeni ju...

Asllan Dogjani – Ta mbaroj unë fjalën! Unë nuk të ndërpreva, të dëgjova dhe do të të dëgjoj kur të flasësh. Ta mbaroj unë fjalën, sepse e kam për procedurë! Nëse është në dorën tënde për të ma ndërprerë fjalën në mënyrë arbitrare, me arrogancë, bëje!

Nasip Naço – Jo, pra, nuk jua ndërpres unë. Unë edhe te dera dola dhe ju luta në mënyrë demokratike, sepse jemi deputetë europianë.

Asllan Dogjani – Bëje, sepse e ke në dorë ta bësh, ta ndalosh edhe fjalën, por unë po të shpjegoj se pse jemi në këto kushte.

Nasip Naço – Procedura është për buxhetin. Keni ndonjë gjë për buxhetin? Buxheti shtohet me rreth 20 milionë dollarë.

Asllan Dogjani – Po, po, kam edhe për buxhetin. Buxheti është për diskutim, tani unë do të flas për procedurë.

Nasip Naço – Je dakord të shtohen pagat për punonjësit e Policisë, për Gardën, të ketë rritje për sigurimet shoqërore, për investimin e infrastrukturës?

Asllan Dogjani – Patjetër, sepse unë i dua më shumë se ty punonjësit e policisë, sepse kam punuar në Policinë e Shtetit, por më lejo ta mbaroj fjalën për procedurë!

Pra, ju na keni mohuar të drejtat kushtetuese për të ngritur komisionet hetimore. Ne kemi kërkuar disa komisione hetimore, të cilat ju nuk na i keni lejuar. Ju na keni caktuar bashkëkryetarin e reformës zgjedhore. Pra, çfarë na ka ngelur tjetër neve?! Bëjini këto, zotëri! Le t'i ngremë komisionet hetimore dhe të kalojmë në normalitet! Nuk mundet të na e caktojë neve mazhoranca bashkëkryetarin e reformës zgjedhore! Ejani t'i bëni këto dhe unë jam i pari që do të vij në të gjitha komisionet dhe do të kthehem në normalitet! Ne kërkojmë një të drejtë kushtetuese dhe ju nuk na lini. Të vetmet instrumente që ka në dorë opozita shqiptare janë komisionet hetimore, interpelancat dhe seancat dëgjimore për të kontrolluar qeverinë. Ju pse na pengoni? Pse keni frikë të na lejoni të ngremë komisionet hetimore? Cila është arsyeja? Ne nuk po e bëjmë për asnjë arsye tjetër. Unë po flas publikisht. Ejani të ngremë komisionet hetimore, të respektoni Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike që ka kërkuar të caktojë bashkëkryetarin e reformës zgjedhore dhe unë personalisht e publikisht po jua them se do të jem i pari që do të vij në normalitet!

Nasip Naço – Nuk besoj se ke aq fuqi sa të ndalosh edhe të tjerët. Të lutem, a do të na lejosh të dëgjojmë ministrin e Brendshëm!

Asllan Dogjani – Po, do ta dëgjojmë edhe ministrin, sepse mua më intereson të flasim për buxhetin, për faktin që ka të bëjë me të gjitha uniformat të cilat sot e kësaj dite nuk u del paga për të jetuar, por po flas për procedurë. Diskutimi për buxhetin është tjetër gjë. Sigurisht do ta dëgjojmë edhe ministrin, sepse më intereson edhe për taksapaguesit shqiptarë, për oficerët, për infermierët.

Nasip Naço – Ju lutem, dëgjojeni ministrin në mënyrë demokratike, zoti Dogjani!

Asllan Dogjani – Më dëgjo një herë, sepse ti fillove me këtë! Pra, ju jeni arsyeja për të cilën ne jemi këtu, sepse na keni penguar të ngremë komisionet hetimore.

Nasip Naço – Nuk jam unë, por gjendja juaj e dëshpëruar. Të lutem, ta lejojmë ministrin Balla të flasë, në lidhje me buxhetin!

Asllan Dogjani – Patjetër, por kjo është arsyeja. Mos abuzo me të drejtat, sepse nuk ka asnjë arsye tjetër! Bëjini këto dhe unë jam i pari që do të vij në normalitet, në Komisionin e Sigurisë, në parlament dhe kudo! Zotëri, ti mendon se ne kemi qejf të dalim e të pengojmë komisionet?! Jo, ne kemi dëshirë të flasim, të diskutojmë për buxhetin. Ndoshta juve ju shkon për shtat që të mos vijmë të diskutojmë fare për buxhetin. Kjo mund të jetë! Ne kemi dëshirë, por na keni vënë në një pozitë të tillë, ku ne nuk kemi se çfarë të bëjmë.

Tani, le ta dëgjojmë ministrin!

Nasip Naço – Faleminderit!

Zoti Balla, fjala është për ju.

Taulant Balla – Mirëdita, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë, anëtarë të Komisionit për Sigurinë Kombëtare,

Momenti kur ministrat raportojnë përpara komisionit të tyre përgjegjës për fushën e tyre të përgjegjësisë për buxhetin e ri të shtetit është një moment i rëndësishëm, sepse duhet ta pranojmë të gjithë që nëpërmjet buxhetit jetësohen të gjitha politikat dhe prioritetet në çdo ministri.

Si anëtar i kësaj qeverie, së pari, dua të ndaj me Komisionin për Sigurinë Kombëtare se fakti që buxheti i vitit 2024 jo vetëm është buxheti më i madh historik, i shtetit shqiptar, duke kaluar për herë të parë shumë prej 7 miliardë eurosh si buxhet i shtetit, pa harruar për asnjë çast se vetëm 10 vjet më parë buxheti i shtetit ishte nën vlerën prej 3 miliardë eurosh, tregon që kemi një rritje 2 apo 2,3 herë krahasuar me buxhetin e 10 vjetëve më parë dhe hapin e madh dhe të rëndësishëm që ka bërë shteti shqiptar dhe ekonomia e vendit tonë.

Natyrshëm, ky buxhet vazhdon të jetë një buxhet social, edhe për shkak të qasjes që ka mazhoranca qeverisëse. Ju informoj se gati 1/3-ta e buxhetit shkon për të mbuluar të gjithë qasjen sociale të qeverisjes, me një fokus të veçantë te pensionet, te pagesa e papunësisë, te pagesat e tjera me karakter social, shtuar këtu edhe bonusin e bebes për të gjitha familjet e reja shqiptare që i gëzohen ardhjes në jetë të fëmijës së tyre.

Duke kaluar te fusha e mbulimit të ministrisë që unë drejtoj dhe te fusha e mbulimit ku Komisioni juaj ushtron kontrollin parlamentar, dua ta informoj Komisionin tuaj të nderuar se kemi të bëjmë me një buxhet ku edhe për Ministrinë e Brendshme është i njëjti parim. Është buxheti më i madh që ka pasur ndonjëherë Ministria e Brendshme. Kemi një rritje me gati 8%, krahasuar me buxhetin e një viti më parë. Për ta kaluar në vlera nominale, buxheti i Ministrisë së Brendshme është 25,9 miliardë lekë, afërsisht 250 milionë euro. Krahasuar me vitin 2023, rritja është 1,8 miliardë lekë ose 8%. Për zërat kryesore të buxhetit, natyrshëm, unë do ta ndërlihdh raportimin me prioritetet kryesore qeverisëse në fushën që mbulon Ministria e Brendshme.

Për sa u përket shpenzimeve, pagave, sigurimeve shoqërore, patjetër që ky është zëri më i rëndësishëm prej 19,7 miliardë lekësh, me një rritje 8%. Dua ta informoj Komisionin se këtu nuk përfshihet pjesa që do të alokohet përmes buxhetit ose përmes parashikimit që ne kemi bërë në total për rritjen e pagave. Gjithashtu, dua t'ju informoj se në buxhetin e shtetit për vitin 2024 janë planifikuar rreth 400 milionë euro, të cilat do të ndahen më pas me vendim për rritjen e pagave në sektorë të ndryshëm, ku një prej sektorëve përfitues është edhe Policia e Shtetit, pra Ministria e Brendshme . Për buxhetin e Ministrisë 19,7 miliardë lekë, pra rreth 190 milionë euro, shkojnë për pagat dhe për sigurimet shoqërore, ku përsëri kemi një rritje 8%, krahasuar me vitin 2023. Ndërkohë, e gjithë kjo është gati sa 3/4-tat ose 76% e buxhetit të Ministrisë së Brendshme.

Për shpenzimet e tjera, kryesisht shërbime dhe mallra, ne kemi vendosur një tavan prej 4,4 miliardë lekësh. Edhe këtu, përsëri kemi një rritje në raport me buxhetin e vitit 2023, ndërkohë që kjo zë 16,9% të të gjithë buxhetit.

Për shpenzimet për investime do të kemi 2 burime financimi: financimin e brendshëm dhe financimin e huaj. Për financimin e brendshëm, pra nga buxheti i shtetit, kemi 1,5 miliardë lekë, që në raport me buxhetin arrin vlerën 5,6%. Për shpenzimet për investime me financim të huaj kemi vendosur një tavan prej 387 milionë lekësh. Këtu natyrshëm do të përfshihen grantet, të cilat nuk do të jenë pjesë e këtij raportimi, siç ju e dini.

Ndërkohë, për vitin 2024 në krahasim me planin fillestar të buxhetit për vitin 2023, kemi një rritje të buxhetit të shtetit edhe në mbështetje të strukturave të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës.

Në buxhetin e vitit 2024 për Policinë e Shtetit parashikohet të ketë një rritje në masën 6% krahasuar me vitin e kaluar dhe, sipas zërave të shpenzimeve, rritja e financimit rezulton të jetë si

më poshtë: për shpenzime personaliteti kemi një rritje 6%; për mallra dhe shërbime kemi një rritje 7% dhe për investime të tjera 6%.

Për sa i përket Gradës së Republikës, kemi parashikuar një rritje në masën 15%, sipas zërave të shpenzimeve të ndara sipas nevojave që janë paraqitur dhe janë pranuar nga kërkesat që kanë ardhur nga institucioni i Gardës së Republikës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është shumë e rëndësishme të kuptohet synimi i Ministrisë së Brendshme, si pjesë e qeverisë së Kryeministrit Rama, për të adresuar prioritetet e veta. Dua të informoj Kuvendin e Shqipërisë se përmes këtij financimi nga buxheti i shtetit synohet të kemi një rritje të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, kundër trafikëve, kundër korrupsionit, natyrshëm me një fokus të theksuar edhe kundër terrorizmit. Gjithashtu, është tepër i rëndësishëm forcimi i kuadrit ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe, e ritheksoj, kundër terrorizmit.

Rritja e sigurisë publike dhe e sigurisë rrugore përmes rritjes së kapaciteteve në burime njerëzore dhe në infrastrukturë do të jenë objektiva kryesore në rritjen e forcës kontrolluese të territorit, që është shumë e rëndësishme, nga ana e Policisë së Shtetit, pa harruar këtu policimin në komunitet, ku besoj se ndaj bashkë me ju vlerësimin e mbarë publikut për sa i përket vijimit të implementimit në territor të paketës së sigurisë në shkolla dhe një pjesë e rëndësishme e qasjes sonë të policimit në komunitet i dedikohet pikërisht rolit të ri që ka marrë Policia e Shtetit në lidhje me sigurinë në shkolla dhe në perimetrin e sigurisë pranë shkollave.

Nuk duhet të harrojmë që pjesë e prioritetëve tona mbetet forcimi i masave në luftën kundër çdo lloj forme të krimeve ndërkufitare dhe trafikëve të paligjshme, me synim ato që edhe Kuvendi i Shqipërisë ka thënë në rezolutat e veta, që kanë të bëjnë me rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve sipas standardeve të Bashkimit Europian dhe standardeve të Marrëveshjes Shengen.

Na duhet të vazhdojmë ta çojmë përpara procesin e vetëpastrimit në Policinë e Shtetit, për të garantuar një polici shteti sipas standardeve më të mira të Bashkimit Europian. Procesi i vetëpastrimit ka hyrë tashmë në një fazë të re dhe të pakthyeshme. Siç jeni në dijeni, jemi në proces të përzgjedhjes së drejtuesit të ri të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. Dua t'ju informoj se brenda buxhetit të Ministrisë së Brendshme është parashikuar edhe një mbështetje buxhetore për forcimin dhe rritjen e efikasitetit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Sfida me të cilën përballlet sot Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera të sigurisë ka të bëjë me përmirësimin e menaxhimit të teknologjisë së informacionit, qoftë për garantimin e sigurisë së shërbimeve, qoftë për përmirësimin e cilësisë së komunikimit dhe për atë që ka të bëjë me transmetimin e informacionit. Unë mendoj se në buxhet ne kemi parashikuar, në fakt, një mbështetje për përmirësimin e të gjitha rrjeteve dhe sistemeve digjitale brenda Policisë së Shtetit, edhe pse gjatë vitit 2024, në pjesën e parë të vitit, ne do të marrim kohën e duhur për hartimin e një sërë projektesh, të cilat kanë të bëjnë pikërisht me një qasje të re të përmirësimit të komunikimeve digjitale të Policisë së Shtetit me qytetarët. Kështu që, gjatë vitit 2024 shpresoj se të kemi mundësi, edhe përmes ndërhyrjeve që do të bëhen në buxhetin e shtetit pas gjysmës së parë të vitit, për të marrë financime për projekte të reja të rëndësishme, të cilat lidhen me teknologjinë e informacionit apo me sfidën e aplikimit të inteligjencës artificiale edhe në sektorin apo në fushën që mbulon Policia e Shtetit.

Na duhet të kemi një përmirësim të vazhdueshëm të sigurisë së personaliteteve, vendase apo të huaj, dhe të objekteve të rëndësishme të veçantë, prandaj kemi parashikuar një rritje të mbështetjes buxhetore për Gardën e Republikës, për të rritur sigurinë e magjistratëve. Siç jeni në dijeni, kemi pasur një komunikim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor, natyrshëm edhe me njësinë e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, me qëllim që ne t'i garantojmë të gjitha parashikimet e vendosura në ligj për trajtimin dhe ruajtjen e posaçme të magjistratëve të këtyre njësive, qoftë prokurorë apo gjyqtarë. Dua t'ju informoj se shtohet numri i punonjësve të Gardës së Republikës, në mënyrë që ne të kemi mundësi t'i ushtrojmë këto përgjegjësi. Në këtë aspekt, dua t'ju informoj në mënyrë të detajuar se rritja e numrit të punonjësve në këtë institucion është mbuluar me parashikimin e buxhetit të vitit 2024.

Ndërkohë, një sfidë tjetër e Ministrisë së Brendshme, përveç pjesës që lidhet me Policinë e Shtetit, me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, me Gardën e Republikës, ka të bëjë me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Unë besoj se shumë shpejt do të jem edhe në promocionin tuaj, të nderuar, edhe në Kuvendin e Shqipërisë, në përmirësim të legjislacionit në këtë kuadër, qoftë për çështje që lidhen me adresarin, qoftë për çështje që lidhen me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. E rëndësishme është që më në fund po arrijmë në fazën finale, ku për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë kemi një kod unik të adresës, e cila i jep fund një historie të gjatë tranzicioni, kur në Shqipëri adresat identifikoheshin thjesht me vendndodhjen e godinave të caktuara, ndërkohë që çdo qytetar shqiptar duhet të ketë një kod unik adrese. Për këtë qëllim në

buxhetin e shtetit të vitit 2024 janë parashikuar fonde për përmirësimin e Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, ku infrastruktura dhe vetë sistemi i tij e kanë të domosdoshme të përditësohen tashmë, në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave të kohës dhe rreziqeve që kanosen nga sfidat e sigurisë kibernetike.

Nëse do të hyja në prioritetet e fushës së investimeve (shoh këtu deputetë të zonave të caktuara, të cilët kanë interes në këtë këndvështrim) ne do të vazhdojmë me ndërtimin e godinës së komisarariatit të Kurbinit, do të vazhdojmë me ndërtimin e godinës së postës së policisë në Bashkinë e Roskovecit, po ashtu me godinën e komisarariatit të Krujës, të Patosit. Gjithashtu, do të vazhdojmë me pagesat që lidhen me implementimin e projektit në drejtorinë vendore të policisë së Elbasanit, të komisarariatit në Sarandë, të drejtorisë vendore të policisë së Beratit, me qëllim që të vijojmë t'i japim Policisë së Shtetit. Ndërkohë, ftoj edhe anëtarët e Komisionit të Sigurisë për të qenë së bashku në Dibër, ku thuajse ka përfunduar dhe është gati për t'u dorëzuar objekti i ri i drejtorisë vendore të policisë së Dibrës, që është i një cilësie dhe i një standardi tepër të lartë. Kështu që, një sërë investimesh të cilat do të kryhen në infrastrukturë i keni të detajuara në buxhet.

Policia e Shtetit do të mbështetet edhe në blerjen e një sërë automjeteve, të cilat janë të domosdoshme për punën e përditshme të punonjësve të saj. Gjithashtu, kemi planifikuar edhe një fond jo të konsiderueshëm, por të nevojshëm, për furnizimin me armatim të Policisë së Shtetit. Ndërkohë do të vazhdohet me një mbështetje të veçantë për Policinë Shkencore, për Policinë Rrugore dhe për Policinë e Rendit, kryesisht në pajisje, për mbarëvajtjen e punës së tyre.

Për sa u përket pajisjeve të teknologjisë së informacionit, ne kemi planifikuar një fond prej 490 milionë lekësh, kryesisht për blerjen e programeve informatike për administrimin *online* të shërbimeve brenda Policisë së Shtetit, për ngritjen e sistemit të menaxhimit të informacionit për Akademinë e Sigurisë. Edhe këtu dua ta falënderoj Komisionin e Sigurisë, i cili në mënyrë të vazhdueshme i ka adresuar një vëmendje të veçantë Akademisë së Sigurisë. Unë dua ta ndaj me ju lajmin e mirë që tashmë Akademia e Sigurisë është një institucion i akredituar i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe ne synojmë që brenda një kohe të shkurtër, me një pjesë të vendeve partnere, kryesisht me Italinë, të kemi edhe programe të përbashkëta mësimdhënieje në Akademinë e Sigurisë.

Përfitoj nga rasti këtu t'i ftoj djemtë dhe vajzat që i plotësojnë kriteret e parashikuara nga urdhri përkatës për të qenë pjesë e 300 forcave të reja të policisë në shërbimin e patrullave, pra për t'u pranuar dhe për t'u bërë pjesë e Policisë së Shtetit.

Po ashtu, dua të ndaj me ju edhe lajmin, të cilin ia propozoj kryetarit, të nderuar anëtarë të komisionit, për disa ndryshime në ligjin për Policinë e Shtetit, që do ta përmirësonin veprimtarinë e Policisë së Shtetit, por edhe do të na krijonin burime të reja për të rritur rekrutimet në Policinë e Shtetit, duke qenë se kemi një numër të konsiderueshëm vendesh bosh në këtë strukturë, që janë kryesisht në pozicione tepër të rëndësishme, flas këtu për pozicionet nënkomisar dhe komisar, të cilat, siç ju e dini, pjesa më e madhe, pashë këtu kolegun Dogjani apo kolegë të tjerë, si zoti Sterkaj, që kanë punuar ndër vite në Policinë e Shtetit e dinë se sa të nevojshme janë këto nivele gradash për punën operacionale në territor.

Siç ju thashë, për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore kemi parashikuar disa fonde që lidhen me mbarëvajtjen e punës së këtij institucioni, ndërkohë edhe për një mbështetje sa i përket pjesës të mjeteve të transportit që janë të domosdoshme për zhvillimin e hetimeve proaktive nga ana e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në luftën për pastrimin e Policisë së Shtetit.

Sa i përket shërbimit të Gjendjes Civile, siç ju informova, edhe këtu do të jetë e gjithë qasja e re. Për të garantuar implementimin e të gjithë kuadrit ligjor për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile do të ketë një mbështetje buxhetore prej rreth 110 milionë lekësh për përmirësimi i infrastrukturës të pjesës *hardware* dhe *software* të Regjistrit Kombëtar dhe të Gjendjes Civile.

Në fund, ju kërkoi ndjesë se ndoshta u zgjata, dua t'i ftoj anëtarët e komisionit, pavarësisht krahëve politikë nga të cilët vijnë, pasi ky është një buxhet për Ministrinë e Brendshme që natyrshëm adreson pjesën më të rëndësishme të objektivave. Ne kemi hyrë në një fazë të re të përgatitjes së një sërë projekteve të reja, të cilat në një moment të dytë, gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2024, përmes rialokimeve do të marrim financime, sepse synimi i kësaj ministrie, duke qenë se Policia e Shtetit përfaqëson rreth 80% të të gjithë strukturës së ministrisë, fokusi është te Policia e Shtetit pa harruar edhe të gjitha institucionet e tjera që janë pjesë e përgjegjësisë së kësaj ministrie.

Thirrja ime për të gjithë kolegët deputetë, majtas apo djathtas, në qendër apo kudo qofshin, është që përtej ndasive politike Policia e Shtetit ka nevojë për mbështetjen e të gjithëve. Rritja e besimit të qytetarëve për Policinë e Shtetit tashmë ka hyrë në një fazë të re, kështu që unë mendoj se çuarja përpara i të gjitha këtyre prioriteteve do ta bëjë Policinë e Shtetit institucionin më të besuar nga qytetarët, nisur edhe nga fakti, për të cilin besoj se të gjithë biem dakord, që për çdo lloj problematike institucioni i parë tek i cili përplasen qytetarët është institucioni i Policisë së Shtetit.

Ftesa ime është që ta mbështesim buxhetin e shtetit dhe buxhetin për Ministrinë e Brendshme në mënyrë të veçantë për t'i çuar përpara këto prioritete.

Kryetar, faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Vetë fakti që janë 20 milionë euro më shumë se viti i kaluar tregon qartë për nivelin e përgatitjes. Unë si deputet dhe si kryetar i këtij komisioni ju falënderoj për këtë nivel!

Po vazhdoj më tej duke ia dhënë fjalën relatores, zonjës Dhima.

Më pas fjalën do ta marrin deputetët për pyetje dhe diskutime.

Zonja Dhima, ju lutem, në mënyrë të përmbledhur!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin e buxhetit të Ministrisë së Brendshme për vitin 2024!

Para se të filloj diskutimin e projektbuxhetit për vitin 2024, më lejoni t'ju falëndero, zoti Ministër, për angazhimin, korrektësinë, vëmendjen, vizionin, këmbënguljen, si dhe rezultatet e arritura deri tani nga organizata e Policisë së Shtetit, të cilën ju e drejtoni me dëshirën dhe ambicien e madhe për vendosjen e një standardi të ri në autoritetin dhe dinjitetin e Policisë së Shtetit, në arritjen e standardeve të jetesës, në përmirësimin e kushteve të shërbimit të çdo punonjësi policie që nga kushtet financiare e deri te kushtet e strehimit kur ata shërbejnë jashtë vendbanimit, si dhe krijojnë edhe familjet e tyre të reja!

Në fakt, siguria e turistëve në këtë sezon turistik historik ishte një test dhe njëkohësisht edhe një barometër shumë i rëndësishëm për Policinë e Shtetit, pasi me rolin dhe misionin e saj e certifikoi vendin tonë si një destinacion të sigurisë turistike, si një destinacion europian me dukuri natyrore, mikpritje të pakonkurrueshme dhe me një siguri mbresëlënëse.

Gjithashtu, paketa e sigurisë në shkollë, e cila garanton ditë për ditë sigurinë e nxënësve jo vetëm brenda ambienteve të shkollës, por edhe në mjediset e jashtme, nëpërmjet operacionit kombëtar “Tempulli”, i cili është një nga operacionet më të mëdha të zhvilluara ndonjëherë, ka dhënë dhe po jep rezultatet konkrete. Po ashtu edhe pastrimi i Policisë së Shtetit...

Nasip Naço – Zonja Dhima, ju lutem, flisni për buxhetin!

Antoneta Dhima – Dakord, por pjesë e buxhetit janë edhe këto, madje edhe me kosto financiare.

...ka si qëllim largimin nga trupa e shëndoshë e Policisë së Shtetit të elementëve të dëmshëm dhe të inkriminuar, të cilët njollosin punën e palodhur të mijërave uniformave blu që shërbejnë me vendosmëri dhe që janë në mbrojtje të jetës dhe njëkohësisht edhe të pronës së qytetarëve.

Janë këto projekte që po japin çdo ditë rezultatet e mirëpritura dhe njëkohësisht të dëshiruara nga qytetarët dhe familjet shqiptare, të cilat duan dhe dëshirojnë një polici më të fortë dhe një nivel më të lartë të sundimit të ligjit. Rezultatet e arritura deri tani patjetër që janë një motivim dhe një obligim juaji, por njëkohësisht edhe i organizatës së Policisë së Shtetit për ta thelluar më tej luftën kundër krimit të organizuar, grupeve kriminale, gjetjen dhe vënien para përgjegjësisë së personave në kërkim, zbulimin e ngjarjeve të rënda pa autorë, zbulimin e vrasjeve të vjetra, të cilat nuk harrohen, nëse autorët nuk do të përballen me drejtësinë, si dhe përmirësimi i sigurisë publike në të gjithë territorin.

Unë dua t'i vlerësoj të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, respekt dhe mirënjohje për të gjithë ata që me angazhimin, përgjegjshmërinë dhe vendosmërinë e treguar në krye të detyrës dhe për të plotësuar misionin e tyre, siç janë forcat RENEJA, FNSH-ja, Delta, Policia Alpine, njësia policore, njësia kufitare, patrullat e përgjithshme "Shqiponjat", forcat operacionale dhe të gjitha drejtoritë vendore të policisë, njëkohësisht edhe Policia Rrugore dhe Kriminale, po garantojnë çdo ditë rendin dhe sigurinë në Shqipëri.

Unë jam besimplotë se me këmbënguljen dhe angazhimin tuaj ju jeni duke punuar fort për rritjen sa më shpejt të besimit të qytetarëve për Policinë e Shtetit, duke përmirësuar çdo fushë të përgjegjësisë suaj, si dhe në çdo drejtim të aktivitetit dhe të misionit tuaj, atë të garantimit dhe të sigurisë publike.

Në fakt, buxheti ka një rëndësi të veçantë, mua më vjen keq që ne po e diskutojmë buxhetin e Ministrisë së Brendshme në kushtet *online*, gjë, e cila nuk është për fajin tonë, por të opozitës. Ne ishim të pranishëm këtu, sipas njoftimit që ishte bërë, për ta zhvilluar mbledhjen në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, por për arsyet që dihen ne po e zhvillojmë mbledhjen *online*.

Buxheti i Ministrisë së Brendshme për vitin 2024 është në shumën 25,9 miliardë lekë dhe ka një rritje krahasuar me vitin 2023, nëse do të jetë në përqindje, 8%, ndërsa në vlerë është 1,8 miliardë lekë më shumë. Sipas zërave kryesorë, shpenzimet apo ndryshimet në raport me planin ose me buxhetin e vitit 2023, na paraqiten: shpenzimet për personelin, ku përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore, kanë një vlerë prej 19,7 miliardë lekë ose një rritje prej 8% krahasuar me

buxhetin fillestar të vitit 2023. Ndërsa, por ta krahasojmë në raport me totalin e buxhetit, këto shpenzime zënë vlerën 70 ose në përqindje 76%.

Shpenzime të tjera janë ato ku përfshihen mallrat dhe shërbimet, njëkohësisht edhe transferta ku vlera është 4,4 miliardë lekë ose me një rritje 8% krahasuar me buxhetin e vitit 2023, ndërsa në raport me buxhetin në total është 16,9%. Po kështu, edhe shpenzimet për investime, të cilat janë shumë të rëndësishme, kryesisht ato me financim të brendshëm, kanë një tavan buxhetor prej 1,5 miliardë lekësh ose një rritje 1% krahasuar me vitin 2023, ndërsa në raport me totalin e buxhetit të Ministrisë së Brendshme që është 5,6%. Edhe investimet e huaja i vlerësojmë si të rëndësishme, pasi donatorë të ndryshëm kanë mbështetur dhe mbështesin Policinë e Shtetit. Ky tavan buxhetor shkon në vlerën 387 milionë lekë, ndërsa në raport me buxhetin në total është 1,5%.

Në fakt, rritja e buxhetit për vitin 2024 krahasuar me planin e vitit 2023, është kryesisht mbështetje për strukturat e Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës. Konkretisht, për Policinë e Shtetit parashikohet një rritje plus 6%. Nëse do t'i krahasojmë me zërat, pagat e personelit kanë një rritje me 6%, shpenzimet operative, ku përfshihen mallrat dhe shërbimet, kanë një rritje me 7%, ndërsa investimet e brendshme kanë një rritje me 6%.

Referuar Gardës së Republikës, buxheti për vitin 2024 parashikohet me një rritje në masën 15%. Konkretisht, shpenzimet e personelit kanë një rritje 13,5%, mallrat dhe shërbimet 15,4% dhe investimet pothuajse janë 2 herë më shumë sesa viti 2023. Në bazë të tavaneve të parashikuara në projektligjin për buxhetin rezulton se këto tavane garantojnë mbështetje dhe funksionim normal të strukturave të Ministrisë së Brendshme, nëpërmjet financimit të shpenzimeve më të domosdoshme, kryesisht rritjen e pagave. Ministri e tha gjatë fjalës së tij jo vetëm sot, por edhe në vazhdimësi e ka përmendur, që Policia e Shtetit duhet vlerësuar, por ajo që duhet vlerësuar më shumë është një pagë më e mirë për një punë të mirë; financimi i projekteve të uniformave; trajnimi me ushqime, edhe ky ka qenë një problem dhe është zgjidhur, si dhe shpenzime të tjera të domosdoshme për realizimin e misionit të Policisë së Shtetit.

Si prioritete kryesore mund të përmendim rritjen e hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve, korrupsionit, terrorizmit, si dhe forcimit dhe koordinimit ndërsektorial ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar dhe njëkohësisht edhe terrorizmit; rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimit të kontrollit të territorit me policimin në komunitet; forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafiqeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve, sipas

standardeve të BE-së; përafrimin e standardeve të shërbimeve policore me ato të BE-së; përmirësimin e kushteve të punës nëpërmjet financimit të disa projekteve të rikonstruksioneve të drejtorive të policisë në qarqe (ministri i përmendi disa prej tyre); mirëmbajtja dhe përmirësimi i menaxhimit të sistemit të IT-së për programin e sigurisë së shërbimeve dhe njëkohësisht cilësisë së komunikimit në transmetimin e informacionit; përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së personaliteteve vendase dhe të huaja, të objekteve të rëndësisë së veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standardet europiane në fushën e sigurisë, duke synuar arritjen e një niveli 100% të sigurisë; rritjen e nivelit të sigurisë së personaliteteve të larta shtetërore dhe të objekteve të rëndësisë së veçantë, duke marrë masat e nevojshme për mbrojtjen fizike të personaliteteve të ndryshme vendase dhe atyre të huaja, të cilët vizitojnë vendin tonë dhe përmirësimi i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Infrastruktura e saj dhe vetë sistemi e kanë të domosdoshme të përditësohen në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave dhe kohës nga rreziqet që u kanosen nga aktorët keqdashës.

Si prioritet, sa i përket fushës së investimeve, ministri e tha edhe gjatë fjalës së tij, janë disa projekte të reja, ndërtimi i godinës së komisarariatit të Kurbinit, ndërtimi i godinave të postës së policisë Roskovec, për këtë dua ta falënderoj, pasi situata e dy postave të policisë si në Roskovec, edhe në Patos, meqenëse unë jam deputete e qarkut të Fierit, janë në një gjendje jo të shumë të mirë për ta ushtruar aktivitetin normalisht; ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinës së komisarariatit të policisë së Krujës; rikonstruksioni i godinës së informacionit, ndërtesa 3-katëshe, si dhe projekte në vazhdim, siç është drejtoria vendore e Elbasanit; godina e komisarariatit të Sarandës dhe drejtoria vendore Berat dhe njëkohësisht blerja e automjeteve speciale dhe e automjeteve me kalueshmëri të lartë, të cilat do të përdoren nga postat e kufirit, si dhe armatime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionin e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit. Blerja e pajisjes speciale për Policinë Shkencore dhe Policinë Rrugore, njëkohësisht edhe blerja e pajisjeve teknologjike, pasi dihet që teknologjia është shumë e domosdoshme në kushtet në të cilat ne jemi; programe, njëkohësisht mbështetja e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, i përmendi edhe ministri, rikonstruksioni dhe rindërtimi i godinës së Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, blerja e pajisjeve dhe orendive dhe mbështetje të tjera për blerjen e mjeteve të transportit për këtë agjenci, si dhe mbështetja e programit të Shërbimit të Gjendjes Civile.

Në fakt, unë theksova disa nga prioritetet e Ministrisë së Brendshme, edhe ministri gjatë fjalës së tij i tha. Jo vetëm sot, por gjatë gjithë kohës që është në detyrën e ministrit të Brendshëm ai ka përmendur nevojën, domosdoshmërinë dhe njëkohësisht punën që është bërë.

Duke marrë parasysh sa thashë më sipër dhe duke pasur konsideratën më të lartë, pasi rendi dhe siguria janë shumë të rëndësishme dhe janë tema aktuale në mbarë botën, në një kohë kur vendi dhe rajoni, dhe jo vetëm, është duke investuar maksimalisht në rritjen dhe mbështetjen buxhetore për këtë sektor shumë të rëndësishëm, që është mbrojtja e rendit dhe e sigurisë për qytetarët, do t'i ftoja kolegët deputetë që ne patjetër ta mbështesim jo vetëm buxhetin e Ministrisë së Brendshme, që hap siparin e diskutimit të buxhetit për institucionet që do të raportojnë pranë Komisionit të Sigurisë Kombëtare, por edhe për institucionet e tjera t'i miratojmë buxhetet, pasi do t'i hapim rrugën më tej zbatimit të projekteve të rëndësishme dhe shumë të domosdoshme. Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Dhima!

Ju në fjalën tuaj në mënyrë të përmbledhur dhe në këndvështrim tjetër nga ministri na thatë disa gjëra, por unë do të doja që kolegët e tjerë të jenë më të përmbajtur në pyetje dhe diskutime për efekt edhe të mënyrës së votimit *online*.

Fjalën e ka kërkuar zonja Resulaj për pyetje.

Do të doja edhe nga kolegët e tjerë që pyetjet të jenë pyetje dhe komentet komente, në mënyrë që t'i ndajmë.

Zonjën Dhima e lashë të fliste pak më gjatë për shkak se ishte relatores, por kolegëve të tjerë do t'ua ndërpres fjalën, për efekt të menaxhimit sa më të mirë të mbledhjes. Të gjithë kolegët pyetjet që kanë t'ia drejtojnë ministrit të Brendshëm.

Zonja Resulaj, fjala për ju për pyetje.

Pranvera Resulaj – Këto gjëra ndodhin për shkak të mbledhjeve *online*, ndërkohë që mbledhjet duhej të ishin bërë në komision.

Besoj se tani më dëgjoni.

Zoti kryetar, unë ju falënderoj, meqë më thatë ta bëj direkt pyetjen!

Në fillim do të bëj një koment të shkurtër për të mbërritur te pyetja.

Dua ta falënderoj ministrin më shumë për punën që ka bërë deri tani sesa për prezantimin e projektbuxhetit, siç bëri edhe kolegja ime gjatë relatimit të saj, kjo, pasi puna e tij është e dukshme dhe është vlerësuar nga qytetarët.

Për hir të së vërtetës performanca e Policisë së Shtetit ka ardhur gjithnjë e në rritje. Zoti Ministër, ajo që dua t'ju them është se fryma e vetëpastrimit në polici dhe mbështetja pa kushte e pjesës së shëndoshë të strukturave brenda sistemit është meritë e drejtpërdrejtë juaja.

Një nga programet që ju përmendët, por e përmendi edhe relatorja gjatë diskutimit të saj, është paketa e sigurisë në shkolla si pjesë e policimit në komunitet, duke gjetur mbështetje tek opiniononi, përfshi këtu prindër, nxënës dhe mësues. Unë do të merrja shkas nga kjo për t'u fokusuar te një pyetje lidhur me angazhimin maksimal që ka Policia e Shtetit. A mendoni ju që Policia e Shtetit është e mbingarkuar? Në këtë rast, për një performancë dhe një ristrukturim më të mirë: a mendoni se ka nevojë për burime shtesë njerëzore, për logjistikë dhe për infrastrukturë? Në opinionin ekziston mendimi që Policisë së Shtetit i ngarkohen shumë detyra, kjo është diçka shumë e mirë që bëhet, por një nga mënyrat për ta shpërblyer këtë angazhim të tepër është paga.

Po kaloj te pyetja e dytë. Është për t'u përmendur dhe për t'u vlerësuar në këtë buxhet rritja e pagave për të gjithë administratën. Ajo që unë dua t'ju pyes është: a përfiton e gjithë trupa policore nga rritja e pagës? Kur them trupa policore, besoj se ju e kuptoni shumë mirë për çfarë e kam, pra për të gjitha kategoritë që ajo ndahet. A përfitojnë të gjithë, edhe pse në përqindje të ndryshme dhe jo njësoj?

Ju uroj suksese në punën tuaj dhe faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Resulaj!

Zoti Balla, fjala për ju.

Taulant Balla – Mendova se do t'i merrja të gjitha pyetjet dhe do t'ju përgjigjesha për të gjitha së bashku, zoti kryetar, megjithatë nuk ka problem, si ta vlerësoni ju.

Nasip Naço – Unë mendoj se ka edhe kolegë të tjerë që duan të bëjnë pyetje, një pjesë e tyre bëjnë komente të shkurtra, kështu që mendova më mirë pyetje-përgjigje. Më pas do të kalojmë edhe te diskutimet.

Taulant Balla – Dakord.

Në lidhje me pyetjet e zonjës Resulaj, pikë së pari dua të theksoj se është e vërtetë që Policia e Shtetit konsiderohet si një institucion tek i cili kërkohen shpeshherë edhe shërbime që vështirë t'i mbulojmë ne. Dua ta bëj pak më interaktiv diskutimin. Po ju marr një element, të cilin besoj se Policia e Shtetit e ka kryer më së miri gjatë këtij sezoni të rëndësishëm turistik, ku Shqipëria pret që ta mbyllë vitin 2023, deri më 31 dhjetor, me afro 10 milionë turistë. Gjatë punës së Policisë së Shtetit na është dashur të përballemi me nevojën për të mbështetur një sërë

operacionesh kërkim-shpëtimi të qytetarëve të huaj dhe vendas që vizitojnë destinacione të ndryshme të bukurive natyrore të vendit. Kemi pasur 465 raste të tilla në të gjithë territorin, për të cilat punonjësit e Policisë së Shtetit jo vetëm kanë harxhuar mund dhe djersë, por edhe kanë rrezikuar jetën e tyre, duke punuar jashtë orarit dhe gjithçka tjetër.

Dua të jem i qartë, këto nuk janë parashikuar asnjëherë në buxhet, sepse është diçka që kryhet nga ana jonë, prandaj kërkojmë mbështetjen tuaj financiare për Policinë e Shtetit. Është diçka e rëndësishme. Këtu unë dua të nënvizoj nevojën që Policia e Shtetit ka. Në fakt, kemi pasur një diskutim të rëndësishëm në qeveri kur kemi miratuar buxhetin e shtetit për të rregulluar një handicap të trashëguar ndër vite, atë që ka të bëjë me trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj se do të mund ta mbulojmë, qoftë duke ndërhyrë, siç e thashë, me instrumentin e akteve normative për rishikimet e buxhetit, qoftë për buxhetin e vitit 2023 në vijim, por edhe gjatë implementimit apo zbatimit të projektbuxhetit të vitit 2024.

Ndërkohë, unë mendoj se Policia e Shtetit ka nevojë për të rritur kapacitetet e saj në burime njerëzore. Nuk duhet të harrojmë që rekrutimi në Policinë e Shtetit mund të bëhet vetëm përmes kalimit nga Akademia e Sigurisë. Pra, me atë që kemi sot në ligjin “Për Policinë e Shtetit” bëhet përmes Akademisë së Sigurisë. Më pas unë do të rikthehem në Komisionin e Sigurisë për të diskutuar me ju në javët apo muajt që do të vijnë sa u përket ndryshmeve, të cilëve mendoj se u ka ardhur koha për t’i diskutuar së bashku dhe të marrim vendime së bashku, që kanë të bëjnë me mënyrën e rekrutimit, pra duke bërë ndërhyrje në ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Unë mendoj dhe e mbështes idenë për të rikthyer në Akademinë e Sigurisë edhe nivelin *bachelor*, pra në kuptimin që sa të mbarojnë shkollën e mesme të rekrutohet nga Akademia e Sigurisë për të marrë profesionin e nderuar të punonjësit të Policisë së Shtetit. Por, ky është një diskutim që do ta bëjmë së bashku, në një moment tjetër, kur të kemi gati draftin e parë, sepse përpara se ta sjellim atë zyrtarisht në Kuvend, duhet të ulemi me Komisionin e Sigurisë për të parë detajet, propozimet dhe për të dëgjuar mendimet e vlefshme që vijnë nga anëtarët e komisionit, të cilët kanë një eksperiencë ndër vite në këtë fushë. Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Pyetje nga zoti Kollçaku, zoti Sterkaj, zoti Deliu dhe zoti Qefaliaj.

Zoti Kollçaku, fjala për ju.

Ju lutem, pyetje rreth buxhetit.

Bardhyl Kollçaku- Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Komentet u bënë nga parafolësit dhe ne do t'i rezervojmë komentet, sepse edhe vetë ministri nuk i ka qejf komentet, do të kalojmë direkt në pyetje.

Pyetja e parë: zoti Ministër, si është realizuar buxhetit të vitit 2023 për periudhën 9-mujore? Si e mendoni në fund të vitit parashikimin e realizimit të buxhetit për këtë vit?

Pyetja e dytë: në prezantimin tuaj ju folët për një strukturë buxheti, ku rreth 70% janë shpenzime pagash, sigurimesh; 16,9% ose 17% janë shpenzime operative dhe rreth 6% investime. Kjo strukturë buxhetore a mendoni se i realizon detyrat për policinë, për modernizimin e pajisjeve, të laboratorëve, të mbrojtjes kibernetike, të një shërbimi policie inteligjente e me radhë?

Pyetja e tretë: këtë vit ne miratuam ligjin “Për Policinë Bashkiake”. Në vështirimin tuaj apo në vlerësimin tuaj, a është lehtësuar pak Policia e Shtetit nga disa angazhime dhe detyra, që më parë i bënte Policia e Shtetit dhe tani i kanë kaluar Policisë Bashkiake?

Pyetja e katërt: ju përmendët që për shkak të fluksit të madh në sezonin turistik, ne i kemi ndjekur nëpër medie, janë rreth 250-300 raste operacione kërkim-shpëtimi të turistëve, aventurierë, për të cilët nëpër zona të thella janë marrë resurse të mëdha nga buxheti i Ministrisë së Brendshme, a mendoni ju se ka ardhur koha që të gjendet një alternativë tjetër nga buxheti ose nga siguracionet e detyrueshme për këta turistë?

Së fundi, ky është, në fakt, kompliment: më vjen mirë që dëgjoj se po kthehem tek Akademia e Policisë! Ne në mbrojtje, pas një eksperimenti të dështuar me sukses, po i rikthehem prapë Akademisë Ushtarake, kështu që ju përgëzoj për këtë iniciativë dhe besoj që do t'i japë frytet shumë shpejt! Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit!

Fjala për ju, zoti Ministër.

Taulant Balla - Atëherë, do të jem telegrafik në përgjigjet e pyetjeve të zotit Kollçaku.

Dua ta garantoj Komisionin e Sigurisë Kombëtare që realizmi i buxhetit faktik për vitin 2023 do të jetë 100%. Pra, për të gjithë atë mbështetje buxhetore që ju na keni dhënë, me miratimin e buxhetit të vitit 2023, dua t'ju garantoj që i gjithë buxheti do të ezaurohet dhe të gjitha projektet e planifikuara do të jenë në proces realizimi.

Sa i përket strukturës buxhetore, nuk besoj se ka një ministër me një ministri në çdo vend demokratik që nuk do të kërkonte më shumë mbështetje buxhetore. Por duhet të kuptojmë që kjo qeveri ka një sërë prioritetesh. Ne jemi një mazhorancë e majtë dhe kemi një fokus të posaçëm të mbështetja e pjesës më në nevojë të shoqërisë, prandaj 1/3- ta e buxhetit shkon në këtë destinacion.

Nuk duhet të harrojmë asnjëherë që jemi një vend, i cili jep mbështetjen më të madhe në raport me PBB-në nga buxheti i shtetit për skemën e pensioneve. Edhe këtë vit janë planifikuar 250 milionë euro, që shkojnë për mbështetjen e pensioneve, jo vetëm për indeksimin. Natyrshëm, edhe ne ministrat dimë të mirëkuptojmë vendimmarrjen kolegjiale në kuadër të qeverisë. Besoj se fjala e fundit i takon Kuvendit për të sistemuar prioritetet tona të fushës që mbulojmë brenda saj.

Ajo që duhet të kuptojmë është që ne nuk kemi sot projekte gati, të cilat i kemi paraqitur dhe nuk kemi marrë financim. Pra, një pjesë e mirë e projekteve janë në fazë hartimi dhe, natyrshëm, shpresojmë që me rialokimet që do të bëhen gjatë vitit të ardhshëm të marrin mbështetje buxhetore, kryesisht në nevojat imediate, për ta çuar rrejtin e komunikimit digjital brenda Policisë së Shtetit në nivelin që qytetarët kërkojnë, në mënyrë që të garantojmë një interaktivitet më të fortë dhe një bashkëpunim më të fortë me qytetarët.

Kështu që, në këtë pjesë nuk dua të harrojmë edhe mbështetjen që po mundohemi të sigurojmë, edhe përmes financimeve të huaja, kryesisht me grante, sepse pjesa tjetër hyjnë te pjesa që raportohen në buxhet. Në këtë moment dua t'ju informoj se në fillim të vitit të ardhshëm do të gjejmë momentin dhe do të vijmë në komisionin tuaj për të raportuar për të gjitha projektet apo financimet, donacionet që ne kemi nga donatorët e huaj, të cilat janë donacione shumë të rëndësishme. Jemi duke diskutuar me një sërë qeverish partnere për të mbuluar një pjesë të nevojave edhe përmes këtij burimi financimi.

Në lidhje me Policinë Bashkiake, po, është e vërtetë, kolegë deputetë, ajo duhet të hyjë në një fazë të re reformimi. Ligji i ri ka vendosur edhe kritere më të forta. Ndërkohë, dua t'ju informoj që kemi nxjerrë edhe akte nënligjore nëpërmjet vendimeve të qeverisë për zbatimin e ligjit "Për Policinë Bashkiake".

Dua t'ju kërkoj, meqenëse ky është një diskutim publik, kryetarëve të bashkive që t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë procesit të rekrutimit, por edhe qasjes që kryetarët e bashkive duhet të kenë ndaj Policisë Bashkiake. Ajo është një forcë më karakter sigurie dhe natyrisht duhet ta mbështesim që të gjithë. Ne me ndërhyrjen ligjore ia kemi dhënë kompetencat ligjore. Është shumë i rëndësishëm zbatimi në territor dhe ndarja e përgjegjësisë.

Për garantimin e një sezoni turistik të suksesshëm unë e vlerësoj si të domosdoshëm rolin e Policisë Bashkiake në zonat turistike, por policitë bashkiake, kanë dhe një rol tejet të rëndësishëm në parandalimin e krimeve mjedisore. Asnjëherë nuk duhet të harrojmë që qoftë garantimi i pastërtisë, qoftë garantimi i luftës kundër ndërtimeve pa leje dhe formave të tjera të natyrës së krimeve mjedisore, varen nga përgatitja dhe nga roli që luan Policia Bashkiake në bashkëpunim me Policinë e Shtetit. Për këtë qëllim javët në vijim unë do të jem përsëri në territor për të komunikuar me njësitë e qeverisjes vendore, për një harmonizim të punës mes Policisë së Shtetit dhe policive bashkiake.

E vërteta është që ne po u mundësojmë bashkive që të aksesojnë sistemin tonë të gjobave, në mënyrë që ai problem që i ka shoqëruar ndër vite bashkitë, pra pamundësia e mbledhjes së gjobave që ato vendosin, kjo gjë të bëhet përmes sistemit e-Gjobave të Policisë së Shtetit, dhe ne ua transferojmë të gjitha të ardhurat që vijnë përmes tyre, duke rritur forcën tatuese të ligjit nga kjo forcë, sikurse është forca e Policisë Bashkiake.

Sa u përket operacioneve të kërkim-shpëtimit, unë jua thashë, të paktën janë raportuar 465 raste. Ky është një diskutim që duhet bërë, por mos harroni që këta vizitorë vijnë në Shqipëri, sepse është e njohur për mikpritjen, është destinacion tepër i sigurt. Besoj se na bënë të gjithëve krenarë fakti që në një sezon turistik me 9 milionë deri tani, por që mund të mbyllet me 10 milionë, nuk kemi pasur asnjë ngjarje kriminale ndaj turistëve të huaj. Kjo e bën destinacionin turistik më ndër më të sigurtët në botë. Natyrisht, na duhet të rrisim sigurinë pa harruar edhe diçka që e kemi të shkruar në kodin e shqiptarit: kushdo që vjen në Shqipëri është në besën tonë dhe natyrshëm, kemi apo nuk kemi mbulim me siguracion për këdo që kërkon ndihmë nga ana jonë, ajo do të ofrohet.

E mirëpres sugjerimin i zotit Kollçaku që ne të gjejmë një mënyrë për t'i mbuluar këto shpenzime ose njëlloj mbështetjeje financiare për Policinë e Shtetit, por ky është një diskutim që do të na duhet ta bëjmë në një moment të dytë, edhe me sugjerimet që mund të vijnë nga ky komision.

Në lidhje me pyetjen për Akademinë e Sigurisë, po, është e vërtetë që më në fund kemi nisur një fazë të re të Akademisë së Sigurisë për forcën e policisë. E vërteta është që në një kohë të shkurtër kemi arritur regjistrimin si institucion arsimor i arsimit të lartë. Pra, po synojmë, kemi filluar bisedat me një sërë vendesh partnere, sigurimin e programeve për asistencë dhe mbështetje për ngritjen e kësaj Akademie të Sigurisë. Synimi im është që të kemi një akademi që t'i shërbejë

jo vetëm Shqipërisë, por më shumë se kaq, edhe duke përfituar në programet e BE-së për mbështetjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor, pa harruar këtu një bashkëpunim shumëvjeçar që ne kemi me Italinë, me të cilën kemi një sërë institucionesh arsimore të sigurisë, që formësojnë policinë e së ardhmes, në mënyrë që të zhvillojmë me ta programe të përbashkëta të përgatitjes së punonjësve të rinj të Policisë së Shtetit, një polici shteti me dinjitet dhe respekt, duke mos harruar atë që u tha në një pjesë të diskutimeve këtu, që fokusi im nga dita e parë në krye të kësaj ministrie është trajtimi me dinjitet i punonjësve të policisë; mirëtrajtimi i tyre financiar. Përmenda çështjen e pagesë së ushqimit, por të mos harrojmë që jemi në momentin e finalizimit të trajtimit me banesa të 100 punonjësve të parë të policisë. Ne kemi bërë një studim, kolegë deputetë, dhe na rezultoi se 1/10-ta e punonjësve të policisë janë pa banesë. Pra, nëse kemi 10 mijë punonjës policie, 1 mijë prej tyre nuk kanë një banesë, dhe 3ëhstë detyra ime dhe detyra jonë e përbashkët që të ngremë që të gjitha instrumentet e financimit për t'u dhënë mundësinë atyre që të trajtohen me një banesë.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjala për ju zoti Sterkaj. Ju lutem, bëni pyetje pa komente.

Paulin Sterkaj - Faleminderit!

Falënderoj opozitën që po na ruan nga një epidemi e re dhe ne po i zhvillojmë mbledhjet *online*! Kjo nuk është normale. Unë do të pyes ministrin: a do të ketë ndonjë vaksinë për t'u mbrojtur nga opozita, që ne të bëjmë mbledhjet dhe ta zhvillojmë parlamentin në gjendje normale, apo jo?!

Zoti Ministër, ju dëgjoj shpesh që përmendni Policinë e Shtetit. Ju jeni ministër i Brendshëm dhe keni shumë institucione në vartësi, ku një ndër to është dhe Garda e Republikës. Me rritjen e rrogave Garda nuk ka përfituar asnjë rritje, madje as në kreditë e buta. Në këtë projektbuxhet a është parashikuar që Garda të ketë rritje rroge dhe në çfarë mase, por njëkohësisht duhet të përfitojë edhe benefite e tjera, siç i ka policia, sepse edhe Garda ka një subjekt në ruajtje, që realisht është i shenjtë njëlloj si Policia e Shtetit?

Gjithashtu, ju kam dëgjuar shpesh të flisni për sigurinë në shkolla. Me këtë projektbuxhet puna e policisë do të shtrihet në skajin ku fillon krimi, apo aty ku mbaron krimi? Nuk ka krim më të shëmtuar se të shpërndahet lëndë narkotike nëpër shkolla.

Unë do të thosha që policia me këtë projektbuxhet duhet të stimulohet, me qëllim që punën bazë ta fillojë me parandalimin e çdolloj veprimtarie kriminale dhe të vazhdojë atje ku e ka themelin, që shqetëson mbarë komunitetin shqiptar. Ju uroj suksese!

Me sa shoh, ju jeni i kënaqur me këtë projektbuxhet dhe mendoni se do t'i kryeni të gjitha detyrimet tuaja, por kryesorja e mbi të gjitha është pastrimi i radhëve të policisë nga personat e inkriminuar, nga ata që janë mbështetësit kryesorë të krimit të organizuar në shkallë kombëtare. Atëherë, policia nuk do të ketë nevojë për më shumë buxhet, sepse do të kryejë një veprimtari shumë më të aftë për publikun shqiptar, policimi në komunitet nuk i pranon policët e inkriminuar. Prandaj, është detyra juaj ta kërkonti buxhetin, por edhe pastrimi i radhëve të Policisë së Shtetit nga personat e inkriminuar dhe nga ata që realisht i ulin moralin çdo polici të ndershëm dhe çdo qytetari shqiptar kur merret vesh se në Policinë e Shtetit ka ende persona të inkriminuar dhe të lidhur me krimin. Unë do ta votoj buxhetin dhe ju uroj suksese!

Taulant Balla - Po e nis nga pyetja e fundit: “A jam unë i kënaqur me këtë buxhet?”, natyrisht do të doja që në buxhetin e vitit 2024 të dyfishoheshin pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit. Por që të realizohej dyfishimi i pagave i punonjësve të Policisë së Shtetit do të duhej që i gjithë fondi që ne kemi vendosur në dispozicion të rritjes së pensioneve ta merrnim dhe ta vendosnim për këtë zë. Prandaj pyetjes nëse jam i kënaqur, do t'i jap përgjigjen që për sa u përket mundësive që ka Shqipëria për të adresuar prioritetet e Ministrisë së Brendshme ky është, le të themi, ekuilibri i duhur buxhetor për të rakorduar ose për të kënaqur të gjitha nevojat për çdo dikaster.

E vlerësoj vëmendjen tuaj sa i përket Gradës. Dua t'ju informoj se nga dita e parë në krye të kësaj ministrie për secilin nga institucionet e varësisë ka një vëmendje të veçantë. Për Gradën e Republikës gjatë vitit 2023 kemi arritur t'i japim zgjidhje çështjes së pagesës së ushqimit për punonjësit e Gardës së Republikës dhe synojmë që gjatë vitit 2024 këtë arritje ta kemi edhe në Policinë e Shtetit. Gjithashtu, kemi arritur të zgjidhim çështjen e pagesës së qirasë për punonjësit e Gardës së Republikës, të cilët nuk jetojnë në zonën ku kanë vendin e tyre të punës, duke marrë një vendimin për këtë çështje. Natyrshëm, të njëjtin nivel rritjeje që do të kemi për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë vitit 2024 ne synojmë ta kemi edhe punonjësit e Gardës së Republikës.

Siç ju informova, qeveria ka alokuar një fond të posaçëm prej 400 milionë eurosh për rritjen e të gjitha pagave, ku do të trajtohen edhe punonjësit e Gradës së Republikës. Unë do të jem

përpara komisionit dhe përpara jush për të raportuar në lidhje me adresimin e kësaj nevojë, për ngritjen e së cilës gjëj rastin t'ju falenderoj, sepse duhej sqaruar domosdoshmërisht.

Lidhur me pjesën tjetër, është e vërtetë që në buxhetin e shtetit ne kemi prioritet paketën e sigurisë në shkolla, por prioriteti ynë kryesor është lufta kundër krimit të çdolloj forme. Gjithashtu, është e nevojshme mbështetja e policisë me një pjesë të pajisjeve apo makina të larta për shkak se, siç ju e dini fare mirë, sepse jeni deputet në një prej zonave më të thella në vend), aksesit për të kontrolluar kultivimin e kanabisit në zona të thella është i pamundur nëse nuk do ta pajisnim policinë me mjetet e nevojshme për të aksesuar të gjitha këto zona.

Kështu që, krimi luftohet duke luftuar burimet e financimit të krimit dhe e vërteta është që prej shumë vitesh kriminaliteti është financuar nga fenomeni i kultivimit të kanabisit. Po aq e vërtetë është që të dhënat e këtij viti të Policisë së Shtetit, falë punës intensive dhe bashkëpunimit me strukturat partnere dhe këtu dua të nënvizoj *Guardia di Finanza-n*, tregojnë se ne kemi arritur një nivel kontrolli tepër të mirë mbi territorin. Deri para pak ditësh ne kishim mbi 300 mijë bimë narkotike të asgjësuar dhe natyrshëm një sasi tepër të madhe lëndë narkotike kanabis apo lëndë të tjera narkotike, drogash të forta apo lëndë të tjera të përdorura nga kriminaliteti, që jo vetëm janë burim financimi për aktivitetet kriminale, por, sikurse ju e thatë me të drejtë, janë një rrezik për të rinjtë dhe të gjithë shoqërinë tonë.

Në këtë aspekt, shumë faleminderit për pyetjet tuaja dhe për prioritetin që lidhet me trajtimin e Gardës së Republikës!

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Ministër!

Unë besoj se kur ta miratojmë nen për nen do të shikojmë edhe mundësinë për të barazuar Gardën me Policinë, por sot jemi për ta diskutuar në parim.

Zoti Qefalia, keni pyetje?

Xhemal Qefalia - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë nuk do të bëj ndonjë pyetje të veçantë, sepse u ezauruan nga kolegët, por nuk do ta quaja të tepërt punën e mirë të policisë në 2-3 aspekte.

E para, në aktivitetet ndërkombëtare. Jo vetëm zhvillimi i ndeshjes së *Conference League*, por edhe zhvillimi i samitit të fundit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Shqipëri, si dhe nismat e ndërmarra nga dikasteri juaj, zoti Ministër, lidhur me nxënësit, fëmijët, përgëzohen edhe nga qytetarët, me të cilët ne jemi në kontakt.

Zoti Ministër, duke pasur një fluks kaq të madh turistësh dhe parashikohet që vitin tjetër ky numër të jetë edhe më i madh, duke zhvilluar paralelisht edhe vetëpastrimin e policisë, a mendoni se duhet buxhetuar dhe menduar për të ofruar kontingjente të reja në radhët e policisë, pasi tashmë Akademia e Policisë është bërë funksionale dhe po e kryen misionin e saj? Ndoshta kjo do të ndikonte jo vetëm në barazimin e numrave të punonjësve të policisë për banorë, por njëkohësisht do të ulte edhe moshën mesatare të punonjësve së Policisë së Shtetit. A është menduar në buxhet shtimi i radhëve të punonjësve të policisë? Faleminderit!

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Qefalia!

Po, zoti Ministër.

Taulant Balla – Faleminderit!

E para, në buxhet ne financojmë numrin e punonjësve sipas strukturës së Policisë së Shtetit. Pra, dua të ndaj me ju informacionin që në Policinë e Shtetit ne kemi gati 1000 vende të lira, të cilat janë të financuara nga buxheti i shtetit, por ne duhet të krijojmë instrumentet e reja edhe përmes ndërhyrjes në ligjin për Policinë e Shtetit për mënyrën e rekrutimit, duke u rikthyer në një model të ri të pranimeve në Akademinë e Sigurisë, duke filluar që nga niveli *bachelor*. Për këtë na duhet edhe mbështetja e Komisionit të Sigurisë për të rritur vëmendjen publike tek të rinjtë dhe të rejat për profesionin e respektuar të punonjësit të Policisë së Shtetit.

Jeni të mirëpritur që në ditët dhe javët në vijim së bashku të mendojmë një strategji të re se si të ftojme çdo të ri dhe të re. Shpresoj që ne të jemi në kohë për të bërë ndërhyrjet ligjore në mënyrë që në vitin e ardhshëm arsimor 2024-2025 të rinjtë dhe të rejat shqiptare që përfundojnë shkollën e mesme të përzgjedhin edhe profesionin e nderuar të punonjësit të Policisë së Shtetit në studimet që ata do të vazhdojnë. Faleminderit!

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka zoti Deliu. Për momentin nuk po lidhemi dot me zotin Deliu.

Zoti Ministër, dua të bëj edhe unë 2-3 pyetje.

E para, si është buxheti i Ministrisë së Brendshme në krahasim me vendet e rajonit, ato që na rrethojnë, në drejtim të pagave, infrastrukturës dhe mbështetjes që kanë?

E dyta, si do të jetë mbështetja gjatë këtij në drejtim të përmirësimit dhe menaxhimit të sistemit të IT-së, duke pasur parasysh sulmin që ne pësuam nga një vend jo mik vitin e kaluar, dhe çfarë masash janë marrë? A e keni parashikuar dhe mbështetur përmirësimin dhe garantimin e sigurisë së shërbimeve të komunikimit?

E treta, ju keni planifikuar blerjen e disa pajisjeve speciale dhe unë dua të ndalem te Policia Shkencore. Jeni mbështetur vetëm te ndihmat dhe donacionet e vendeve mike apo keni parashikuar edhe buxhet për Policinë Shkencore, pasi dihet që nuk mund të shkojmë atje ku kërkojmë të arrijmë nëse nuk e mbështesim këtë vit Policinë Shkencore?

Çfarë është bërë dhe çfarë do të bëhet nga ana juaj për përmirësimin e buxhetit në lidhje me sistemin TIMS, pasi dihet që edhe në këtë drejtim kemi pasur një sulm? A keni parashikuar mbështetje për sistemin TIMS?

E fundit, zoti Ministër (ajo që me të drejtë ka kërkuar edhe opozita), duan që të vini shpesh në Komisionin për Sigurinë Kombëtare. Një nga arsytet që na bllokuan derën është që ministri nuk ka ardhur shpesh. Ju do të vini në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, jo për të plotësuar tekën e tyre, por për t'u garantuar deputetëve që si Ministër i Brendshëm jeni pranë deputetëve dhe komisioneve? Faleminderit!

Taulant Balla - Faleminderit, zoti kryetar!

E para, në respekt të publikut që na ndjek, unë jam paraqitur në mbledhjen e komisionit 15 minuta para fillimit të mbledhjes. Për të mos bërë lajm, e respektoj dhe vlerësoj vendimin tuaj që kjo mbledhje të zhvillohet *online*, edhe pse, në fakt, në komision kishte prezentë edhe deputetë të opozitës, të cilët ishin dakord që mbledhja të zhvillohej në mënyrën tradicionale.

E para, dua të sqaroj se nuk ka asnjë kërkesë të mbërritur tek unë që unë t'i jem përgjigjur negativisht. Dua t'ju garantoj që sa herë do të kërkonit prezencën time, unë do të jem përballë kolegëve deputetë, sepse duke qenë deputet për 18 vjet e di fare mirë sa i rëndësishëm është raportimi përpara komisioneve të fushës apo përpara deputetëve në seancë plenare.

Lidhur me pyetjet tuaja, ne do t'ju nisim me shkrim tabelat krahasuese me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për të gjitha trajtimet me paga dhe përfitime të tjera të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Lidhur me pyetjen për mbulimin me investime të infrastrukturës kritike, që ka rënë pre e sulmeve kibernetike, ne kemi planifikuar gati 5 milionë euro për t'u investuar për pajisje të teknologjisë së informacionit; për përmirësimin e sistemit TIMS 1,4 milionë euro; për përmirësimin e moduleve të menaxhimit të çështjeve të sallës operative 112 1,12 milionë euro. Dua të kujtoj që komisariati digjital ishte një prej entiteteve digjitale të sulmuara gjatë sulmit kibernetik. Ndërkohë, do të kemi një investim edhe për programet informatike në administrimin *online* të shërbimeve të financës dhe logjistikës.

Po ashtu, synojmë të investojmë edhe në ngritjen e sistemit të menaxhimit të informacionit për Akademinë e Sigurisë Publike me atë që ne e quajmë *e-Akademi*, në mënyrë që t'i përshtatim zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe ata që janë e ardhmja e Policisë së Shtetit, pra, rekrutët ose ata që kanë zgjedhur të jenë punonjës të Policisë së Shtetit në të ardhmen. Në këtë aspekt, dua t'ju garantoj se të gjitha këto nevoja janë të trajtuara, por pa harruar që ne jemi duke përgatitur, konsultuar ...

Për shembull, ju e dini që aktualisht i gjithë sistemi ynë i kamerave të trupit të Policisë së Shtetit nuk funksionon dhe për pasojë kjo ka një impakt negativ në kontrollin dhe sjelljen e punonjësve të policisë në marrëdhënie me qytetarët. Prandaj, jemi duke konsultuar teknologjitë më të mira dhe më të fundit me eksperiencat më të mira të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, për të garantuar që gjatë vitit të ardhshëm, sapo ta kemi gati projektin, të përzgjedhim një teknologji që t'i rezistojë kohës. Synimi ynë është që brenda vitit 2024, jo vetëm të kemi siguruar financimin, por të kemi siguruar edhe implementimin e një projekti të ri të kamerave të trupit të lidhura me sistem radioje raportimi, në mënyrë që ne të ndjekim në kohë reale punën e punonjësve të policisë, të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarin. Nuk e kam fjalën vetëm për Policinë Rrugore, por edhe shërbimet e tjera policore, si Shqiponja, Shigjeta dhe shërbime të tjera. Prandaj, nuk do të jetë e largët dita gjatë vitit 2024 kur unë të jem përpara jush për të raportuar për këtë nivel të ri të monitorimit dhe të komunikimit mes Policisë së Shtetit dhe qytetarëve.

Nasip Naço - Faleminderit, zoti Ministër!

Nëse nuk ka pyetje nga kolegët, kalojmë në diskutime.

Zoti Sinaj, keni pyetje apo diskutim?

Vullnet Sinaj - Unë e ndoqa me vëmendje fjalën e ministrit. Ministri i ri i Brendshëm ka rritur edhe buxhetin e ministrisë me vajtjen e tij në atë ministri. Besoj se të gjithë punonjësit e policisë janë të kënaqur për rritjen e pagave. Është një nga ato efekte pozitive që ky buxhet ka, të cilin ne po bëjmë çmos për ta miratuar, me qëllim që t'u japim mundësi shqiptarëve të kenë një jetë më të mirë dhe rritje të mirëqenies në vitin 2024, penguar përditë nga opozita.

Gjithsesi, mendoj se këto mbledhje, edhe pse bëhen jashtë sallës, e kanë efektin e tyre, sepse ne diskutojmë edhe në këtë mënyrë: kemi dëgjuar prezantimin e njërit prej ministrave, si dhe relacionin e kolegëve për buxhetin. Kështu që, unë jam dakord me të gjithë bashkëfolësit e mëparshëm që ta kalojmë sa më shpejt këtë ligj, me qëllim që të shpërblejmë në një farë mënyre

punën e vështirë që punonjësit e Policisë së Shtetit bëjnë përditë në shërbim të vendit dhe popullit, sidomos në periudhën e turizmit. Shqipëria është konsideruar një nga vendet më të sigurta në botë për turizëm dhe kjo është rezultat i punës së mirë që ka bërë policia.

Nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar, kryetar. Jam dakord me parafolësit dhe mendoj se duhet ta miratojmë. Faleminderit!

Nasip Naço – Po, zoti Duzha.

Zoti Pendavinji.

Ilirian Pendavinji – Përshëndetje!

Faleminderit, kryetar!

Siç e theksuan edhe të gjithë kolegët, është bërë një punë e mirë në drejtim të sjelljes së policisë, detyrave që ajo ka zbatuar, zbatimit të buxhetit dhe bërjes së investimeve të duhura në drejtim të policisë. Në pjesën më të madhe, siç e dëgjuam edhe nga relatori, por edhe nga ministri, kryesisht ky është buxhet pagash.

Gjithsesi, siç u theksua edhe këtu, është bërë punë e mirë për sigurinë në vend dhe sigurinë në shkolla, veçanërisht për të rinjtë, duke qenë se është pjesa më e ekspozuar ndaj fenomeneve, që ne nuk i kemi pasur në kohën tonë, të cilët mund të bien pre e këtyre njerëzve të papërgjegjshëm, që për mendimin tim janë kriminelë.

Unë dua ta përgëzoj ministrin për punën e bërë në fillim të sezonit të ri arsimor, si dhe bashkohem me kolegët për ta votuar buxhetin, me qëllim që të jetë sa më shpejt në funksion të bërjes së punëve. Faleminderit!

Nasip Naço - Faleminderit!

Duke qenë se kolegët nuk kanë më pyetje dhe diskutime edhe për shkak të kësaj mënyre inovative, zoti Ministër, ju falënderoj që ishit prezent në komision! Pamundësitë objektive nuk na lejuan ta zhvillonim mbledhjen edhe me kolegët e tjerë të opozitës. Sigurisht, nuk është as faji dhe as përgjegjësia juaj, por është rruga e zgjedhur nga deputetët e opozitës në këtë ditë të rëndësishme kur diskutohet buxheti.

Unë dua t'ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe për përgatitjen e këtij buxheti! Siç e thanë edhe kolegët e tjerë, shtimi me rreth 20 milionë dollarë më shumë se vitin e kaluar tregon qartë përkushtimin që keni pasur, por edhe mundësitë që janë dhënë nga mazhoranca për të mbështetur Policinë e Shtetit.

Duke ju falënderuar ju dhe kolegët, unë besoj se do ta mbyllim këtë seancë sot me shpresën që kur ta votojmë nen për nen nga kolegët do të kemi amendamente dhe përmirësime të tjera lidhur me shqetësimet që ne kemi marrë nga punonjësit e Gardës, të Policisë së Shtetit dhe Policisë Shkencore. Në diskutimin në parim këto qëndrojnë të gjitha, por në diskutimin nen për nen besoj se do të kemi edhe mirëkuptimin tuaj dhe të Kryeministrit për ta mbështetur sa më shumë Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, sepse në muajt e fundit, në vitet e fundit, është provuar që Policia e Shtetit dhe Garda kërkohen nga të gjithë për t'i shërbyer vendit tonë.

Faleminderit, zoti Ministër!

Këtu e mbyllim mbledhjen, të nderuar kolegë.

Taulant Balla - Faleminderit të gjithëve!

Nasip Naço – Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA